

NJOFTIM PER VEND TE LIRE PUNE

***Intesa Sanpaolo Bank Albania kërkon të punësojë personel në pozicionin:
Agjent për Digital Branch - Tiranë (vendndodhja në Laprakë)***

Përgjegjësite kryesore:

Të përmbushë shërbimet dhe objektivat e bankës ndaj klientëve. Të ofrojë suport në mënyra të ndryshme (chat, email, telefonata, rrjete sociale, etj.)

Të përmbushë kërkesat e klientëve për shërbimet e ofruara nga Digital Branch, të merret me ankesat e klientëve dhe kërkesat e tjera, të delegojë dhe/ose të bashkëpunojë me departamentet e tjera përkatëse për secilin produkt/shërbim. Ka përgjegjësinë të kontaktojë klientët për të mbledhur pagesat e prapambetura.

Aftësitë dhe Kualifikimet:

- Aftësi të forta marketingu dhe shitjeje.
- Aftësi të forta të komunikimit me shkrim dhe me gojë; ndjenjë të lartë përgjegjësie.
- I vëmendshëm në detaje, me qëllime të përcaktuara.
- Aftësi negocimi.
- Të jetë i gatshëm të punojë në grup dhe **me Turne**.
- T`ju përgjigjet telefonatave, në përputhshmëri me treguesit kryesorë të performancës.
- I gatshëm për të ndihmuar kolegët e tjerë të ekipit për çështje të përditshme dhe/ kur jane në vështirësi.
- T`i ofroje klientit pikat e forta dhe më të mira të produktit.
- Angazhim maksimal për t`i ofruar klientit shërbim të shkëlqyer.
- Aftësi për prioritizimin dhe menaxhimin e detyrave të shumta.
- Aftësi komunikimi, aftësi për zgjidhjen e problemeve dhe aftësi analitike.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për t`iu përshtatur një mjedisi në ndryshim.
- Të dëgjojë me kujdes reagimet e klientëve.
- Të përdorë me shpejtësi dhe efikasitet programet dhe telefonin në të njëjtën kohë.
- T`i shpjegojë produktin klientit, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe miqësore.
- Të jetë i orientuar drejt klientit duke e vënë atë në qendër të vëmendjes gjatë bisedës.

Kerkesat:

- Diplomë Universiteti.

- Aftësi të shkëlqyera komunikimi (zë i këndshëm, i qartë dhe mënyrë e saktë në të shprehur).
- Aftësi në ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira me të tjerët.
- Të jetë i motivuar dhe të ketë dëshirë për të punuar në ekip (shpirti i ekipit).
- Njohuri shumë të mira në programet bazë të kompjuterit (Microsoft Office).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze.
- Preferohet njohuri të gjuhës italiane.
- **Përvoja e preferuar:** Të ketë eksperiencë të ngjashme pune në ekip.
- **Mundësi punësimi me kohë të Plotë.**

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Një Curriculum Vitae në gjuhën angleze

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail te recruiting@intesasanpaolobank.al, jo më vonë se **data 05 Gusht 2024.**